



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	17-05-2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHACK	2881/2022		115



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.424/2022

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga:** Eshref Shabani -kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Ilire Mehmeti- Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1457/2020 të datës 15.10.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.182/2020 të datës 06.07.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi në kompleksin banesor

kundër Vendimit me nr.02/120/01-0014880/20 të datës 17.06.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Skenderaj, në çështjen juridike “kompensim material”, , duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 17.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

**I. REFUZOHET si e pa bazuar** ankesa me numër A.nr.182/2020 e datës 06.07.2020 e parashtruar nga ankuesi

**II. MBETET në fuqi** Vendimi me nr.02/120/01-0014880/20 të datës 17.06.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Skenderajt.

A r s y e t i m

Ankuesi: sipas Akt Emërimit nr.2-112-24272 të datës 21.04.2015 ka qenë i punësuar në Komunën e Skenderajt në pozitën Zyrtar për Integritet në Zyrën e Kryetarit të Komunës së Skenderajt, me kërkesën e datës 15.05.2018 i është drejtuar Kryetarit të Komunës së Skenderajt për lejimin e pensionimit të parakohshëm për shkaqe shëndetësore.



Kryetari i Komunës së Skenderajt, me datën 24.05.2018 pas kërkesës së parashtruar nga nëpunësi civil Agim Mitari lidhur me pensionimin e parakohshëm për shkaqe shëndetësore ka marr vendimin me numër NR.02-118/02-0029874/18 me të cilin e ka aprovuar kërkesën duke i lejuar nëpunësit pensionimin e parakohshëm me 70% të pagesës së fundit nga data 01.06.2018 deri me datën 05.05.2020 kur e arrin moshën e pensionimit 65 vjeçare. Tutje me datën 27.04.2020 Burimet Njerëzore pranë Komunës së Skenderajt marrin vendimin me numër Nr.02-118/02-0014150/20 lidhur me pensionimin e nëpunësit civil \_\_\_\_\_ ne të cilin i ndihet kompensimi i pushimit vjetor të pa shfrytëzuar për vitin 2019 si dhe kompensimin e një page përcjellëse.

Ankuesi me datën 18.05.2020 paraqet ankesën me numër të protokollit 02-120/01-001/4880/20 në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Skenderajt kundër vendimit të pensionimit të nxjerr nga Komuna e Skenderajt, për mes të cilës ankuesi pretendon se me rastin e marrjes së vendimit për pensionim Burimet Njerëzore kanë bërë shkele të rëndë sepse vendimi në fjalë është marre një dite para se nëpunësi civil të pensionohet dhe se nëpunësi civil ka pasur pozitën “Zyrtar për Integritet” në Zyrën e Kryetarit të Komunës e jo “Zyrtar i Integritetit” në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme, si dhe pretendim tjetër i ankuesit është se Komuna e Skenderajt duhet që me rastin pensionimit të ankuesit ti kompensoj pushimin e pa shfrytëzuar për vitin 2018 si dhe kompensimin e 3 pagave përcjellëse dhe 3 pagave jubilarë në bazë të Kontratës Kolektive.

Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave me datën 17.06.2020 ka nxjerr vendimin me numër të protokollit 02-120/01-0014880/20 me të cilën e refuzon ankesën e ankuesit si të pa bazuar.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e datës 17.06.2020 me numër të protokollit 02-120/0014880/20 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Skenderajt, me datën 06.07.2020 parashtron ankesën me numër të protokollit 1313/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesën e ankuesit e ka proceduar tek Komuna e Skenderajt për përgjigje në ankesë me datën 14.07.2020, ndërsa me datën 28.07.2020 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Skenderajt bashkë me provat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 17.08.2020, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 15.10.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1457/2020 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 17.08.2020 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 06.01.2020.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova:** Aktgjykimin e datës 15.10.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë me numër protokollit 2435/2022; Ankesën e datës 06.07.2020 me numër të protokollit 1313/2020 parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin e datës 27.04.2020 me numër të protokollit 02-118/02-0014150/20 për pensionimin e ankuesit; Vendimi i datës 17.06.2020 me numër të protokollit 02-120/01-0014880/20 i Komisionit për Zgjedhën e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesa e datës 18.05.2020 me numër të protokollit 02-120/01-0014880/20 drejtuar Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi për pensionim të parakohshëm të datës 24.05.2018 me numër 02-118/02-0029874/18; Dosjen e pushimit vjetor të nëpunësit civil të Vërtetimi i datës 04.05.2020 me numër 02-118/02-001450/20-1; Shkresën përcjellëse të datës 03.07.2020 me numër të protokollit 1297/2020; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 14.07.2020 me numër të protokollit 1358/2020 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës drejtuar Komunës së Skenderajt; Përgjigja në ankese nga Komuna e Skenderajt drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Njoftimi i datës 22.05.2018 lidhur me plotësimin e kushteve për pensionimin të parakohshëm; Akt Emërimi i datës 21.04.2015 me numër të protokollit 2-112-24272; Emalin e datës 19.02.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar te gjitha shkresat e lendes dhe provat e paraqitura dhe konstaton se ankesa e ankuesit është e **pa bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që në bazë të Kontratës Kolektive e Kosovës parasheh që punëtorëve ju takon pagesa në lartësi prej tri (3) paga përcjellëse dhe tri (3) pagave jubilarë si dhe kompensimi i pushimit vjetor për vitin 2018.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 sipas nenit 82 të saj, ndërsa ka pasur një kohëzgjatje prej tri vitesh siç parashihet me dispozitat e nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, përcaktohet që: ***“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”,*** mirëpo neni 81 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, respektivisht paragrafi 1 ka përcaktuar që: ***“Nga MPKK, Palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese. Tërheqja nga kjo MPKK, shpallet në Gazetën Zyrtare të Kosovës”,*** bazuar në këtë Oda Ekonomike e Kosovës si nënshkruese e kësaj marrëveshje më datë 15.09.2017 ka njoftuar Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale se për arsye ligjore tërhiqet nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Neni 82 paragrafi 2 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës përcakton se: ***“Nëse nga MPKK, pasi që i skadon afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga Palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit”,*** mirëpo meqenëse njëri nga nënshkruesit e kësaj marrëveshje është tërheq nga zbatimi i saj tre muaj para skadimit e njëjta nuk vlen nga data e tërheqjes.

Meqenëse konstatohet se nga data 15.09.2017 Kontrata e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk është e zbatueshëm, rrjedhimisht nuk mund të prodhojë asnjë pasojë juridike sepse më nuk është nënshkruar nga institucionet kompetente. Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komuna e Skenderajt ankuesit i ka bërë kompensimin e një page mujore të njëhershme në vlerën e pagesë së fundit, sipas dispozitave të nenit 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe dispozitat e nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë i cili përcakton që: ***“Paragrafi 1. Sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil, gëzon të drejtën e kompensimit”. Paragrafi 2. Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të***

*drejtën e marrjes së një pagese në shumën e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagesë së fundit*, rrjedhimisht Komuna e Skenderajt ka vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi, kështu që Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka konstatuar se marrëdhënia e punës së ankuesit me rastin e pensionimit sipas i ka përfunduar sipas Vendimit e datës 27.04.2020 me numër të protokollit 02-118/02-0014150/20 për pensionimin e ankuesit, atëherë kompensimi i tri pagave me rastin e pensionimit sipas Marrëveshja Kolektive e Kosovës nuk mund të bëhet, ndërsa ankuesit i ka bërë edhe kompensimin e pushimit vjetor për vitin 2019 të cilin nuk e ka shfrytëzuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke e shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit, i cili pretendon se vendimi për pensionim është marr me datën 04.05.2020 një dite para pensionimit të cilën ankuesi e konsideron si shkelje të rëndë, konstaton se ky pretendim nuk është i bazuar sepse në bazë të shkresave të lëndës të dërguara nga vet ankuesi vendimi për pensionim është marr me datën 27.04.2020 i cili është protokolluar me numër 02-118/02-0014150/20.

Ndërsa sa i përket pretendimit se në vendimin për pensionim Burimet njerëzore kanë cek gabimisht pozitën e ankuesit si “*Zyrtar për integritet në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme*” e jo ashtu siç ka qenë me të vërtet ankuesi me Akt emërim “*Zyrtar për integritet evropiane në Zyrën e Kryetarit të Komunës së Skenderajt*” Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ky gabim nuk ka ndikuar asgjë në marrëdhënien e punës së ankuesit apo në të drejtën e për realizimin e kompensimit me rastin e pensionimit.


Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Skenderajt me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.02-120/01-0014880/20 të datës 17.06.2020 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit, ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr. 424/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

  
Procesmbajtëse

Eshref Shabani

  
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesi
- Kryetarit të Komunës së Skenderajt;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Skenderajt dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.